

### 3. Pse tani shoh etiketa energjetika në zonën e verdhë apo portokalli energjetike?


Një nga parimet kryesore të rregullativës të re është eliminimi i etiketës që krijojnë konfuzion me plusa (A+, A++, A+++). Për këto arsye, pajisja e etiketuar sipas rregullativës të vjetër me A++, tani mund t'i takojë klasën F (zona portokalli energjetike). Pavarësisht të etiketimit të tillë, pajisjet janë po aq cilësore dhe ekonomike si më parë

### 4. Pse ende shoh pajisje me klasën A+++ apo me dy etiketa të ndryshme?

Blerësit momentalisht mund të gjejnë pajisje të cilat kanë etiketa (A+, A++, A+++) sipas rregullativës të mëparshme apo sipas rregullativës të mëparshme dhe të re energjetike për etiketim, dhe ashtu do të jetë derisa të gjithë brendet e pranishme në treg nuk transferohen tërësisht sipas rregullave të reja. Kjo i referohet modeleve të pajisjeve të cilat janë pjesë e rezervave të prodhuara para 1 marsit të vitit 2021. Afati përfundimtar deri në të cilin mund të shiten modele të etiketuara sipas rregullave të mëparshme ose të dyja është fundi i nëntorit të vitit 2021.

### 5. Si të krahasojë klasën e vjetër me klasën e re energjetike?

Kur bëhet fjalë për përcaktimin e klasës të re energjetike të pajisjes, nuk ekziston rregull universale për shndërrimin e klasës të re



në të vjetër. Për shembull, situata e zakonshme e pajisjesve të cilat kanë patur klasë energjetike A+++ sipas rregullativës të mëparshme, tani kategorizohet si klasë D apo E nga rregullativa e re.

Ndryshimet e mëdha në treg kanë ndodhur që të bëhet përshtatja e zhvillimit teknologjik, të ndiqet tregu i ardhshëm dhe t'i ndihmohet tregut që të kuptojë më së miri specifikat e pajisjes. Etiketimi i pajisjes sipas rregullativës të mëparshme me etiketat A+, A++ и A+++ ka shkaktuar konfuzion dhe nuk ka lënë hapësirë për zhvillimin e ardhshëm teknologjik. Rregullivat e reja mundësojnë kuptimin më të lehtë të efikasitetit energjetik, rradhëtes të re të produkteve me etiketa të shkronjave nga A (klasa më e lartë) deri në G (klasa më e ulët), si dhe transparenca e të dhënave për pajisjen për një pozitë më të favorshme të konsumatorit.

Nëse produkti i caktuar ndonjëherë i ka takuar kategorisë A++, tani është etiketuar me shkronjën F, ai gjithsesi se është ekonomik dhe cilësorë si më parë. Qëllimi i zbatimit të rregullave të reja është që deri në fund të vitit 2030 të shfrytëzohet maksimalisht potenciali për kursim të energjisë.

### Si të njihni produktin me etiketën e re energjetike

Etiketa aktuale energjetike	Etiketa e re energjetike	НОВА
		QR kodi jep qasje në më shumë informata për modelin
		Klasa energjetike sipas rregullave të reja të etiketimit, A+++ në etiketën paraprake
		Konsumi i vjetor i energjisë kalkulohet me metoda të përmirësuara
		Vëllimi i frigoriferit i shprehur në litra (L)
		Niveli i zhurmës i matur në decibel (dB) dhe me zbatimin e shkallës me katër klasa

Etiketa energjetike për frigorifer pa ngrirës

# PËR ETIKETAT E REJA ENERGETIKE



Me futjen e rregullativave të reja të Bashkimit Evropian, janë bërë ndryshime të mëdha në shtrirjen e klasave energjetike të prodhimeve, duke përfshirë edhe etiketat energjetike, me çrast të gjithë prodhuesit duhet të respektojnë rregullat e reja.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zbatimi i etiketave të reja ende nuk është i detyrueshëm dhe ndiqet dinamika e punës të Bashkësisë Energjetike. Deri në fund të vitit pritet që të miratohet rregullorja e re me të cilën rregullohet ky problem – Rregullore për shënimin e konsumit të energjisë dhe resurseve tjera për produktet që përdorin energji.

## Pse ka ndryshuar klasa?

Etiketat energjetike janë paraqitur në vitet e 1990-ta, kur shumica e pajisjeve ishin shënuar me klasën energjetike E. Me përparimin dhe zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, për kohë të shkurtër në treg janë paraqitur produkte me klasën më të lartë energjetike A. Zhvillimi i mëtutjeshëm ka sjellur deri te produktet më të mira të klasës A, ashtuqë etiketat janë edhe me shenja shtesë (A+, A++, A+++), me qëllim që të dallohen më lehtë. Por, kjo mënyrë e etiketimit nuk është më efikase për Bashkimin Evropian, sepse teknologjia vazhdimisht avancoon. **Konsiderohet se paraqitja e këtyre, me gjithnjë e më shuma plusa, konsumatorit të fundit ia vështirëson marrjen e vendimit dhe e bën konfuz, sepse shumica e pajisjeve janë zhvendosur në „zonën e gjelbërt“ të efikasitetit energjetik.** Qëllimi i zhvendosjes të niveleve, është gjithashtu që të nxiten prodhuesit të investojnë më shumë në inovacion dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë për prodhimin e më shumë produkteve me efikasitet energjetik.



## Çfarë ka ndryshuar?

Në nivel të Bashkimit Evropian, është miratuar vendimi për ndryshimin e etiketës energjetike ku shtrirja e klasave energjetike do të jetë A (klasa më e lartë) deri në G (klasa më e ulët). Që të mundet produkti t'i takojë klasës të re A, tani duhet të përmbush më shumë kriteret sesa në rast të etiketave të vjetra me A+, A++, A+++.

## Si duket ndryshimi?

Ndryshimi më i madh ka ndodhur në pamjen e etiketës energjetike, e cila është shënuar te pajisjet. Në çdo vend ku mund të gjenden informatat për kategorinë dhe efikasitetin energjetik të pajisjes, theksohen parametrat e rinj dhe mënyra e rradhitjes. Ky ndryshim

për momentin i referohet këtyre kategorive: lavatriçe, pjatararëse, frigoriferë, ngrirës dhe televizor. Kur bëhet fjalë për përcaktimin e klasës të re energjetike të pajisjes, nuk ekziston rregull universale për shndërrimin e klasës të vjetër në të re. Gjithashtu, situata e zakonshme e pajisjeve që kanë patur klasë energjetike A+++ nga rregullativa e vjetër, tani kategorizohen si klasë D apo E sipas rregullativës të re.

## Ku na çon kodi QR dhe për çfarë shërben?

Me ardhjen e rregullave të reja, prania e kodit QR me etiketën energjetike është e detyrueshme. Me skanimin e kodit QR, konsumatori ka këqyrje në specifikat teknike të pajisjes të caktuar në bazën e të dhënave për shënimin energjetik të BE (EPREL). Në këtë mënyrë sigurohet se çdo pajisje është në pajtim me standardin e ri të paraparë, si dhe transparencja e informatave më të rëndësishme për përdoruesin, me çrast gjithashtu lehtësohet krahasimi i pajisjeve nga prodhuesit e ndryshëm.

Te ne, sipas Rregullores, zbatimi i detyrimit për shënimin e të dhënave në bazën e të dhënave do të fillojë pas pranimit të RMV në BE.



## Etiketa energjetike për llambat dhe pajisjet tjera për ndriçim

Nga 1 shtatori i vitit 2021 në BE është futur në zbatim etiketa e re energjetike për llambat dhe pajisjet tjera për ndriçim.

Si të njihni produktin për ndriçim me çmim të ndryshueshëm

Etiketa aktuale energjetike      Etiketa e re energjetike

Klasa e ndryshueshme e efikasitetit energjetik për këtë burim të dritës, A++ në etiketën e mëparshme QR kodi jep qasje në më shumë informacione për këtë model

Konsumi i energjisë të këtij produkti është kalkuar me metoda të rafinuara

## PYETJET MË TË SHPESHTA

### 1. A kursen pajisja ime njësoj si më parë pas futjes të rregullave të reja?

Po! Pajisjet janë ekonomike njësoj si më parë. Duke patur parasysh se standardi është ashpërsuar, kurse shkallët e llogaritjes të konsumit të energjisë janë ndryshuar, pajisjet/aparatet sipas rregullave të reja duhet të përmbushin kriteret edhe më të larta që të rradhiten në klasë më të lartë. Kjo e vendos konsumatorin në pozitë të mbrojtur sepse të gjithë informatat për konsumin dhe kursimet janë transparente.

### 2. Në cilat pajisje do të shoh etiketa energjetike sipas rregullativës të re?

Rregullat e rregullativës të re të Bashkimit Evropian për momentin zbatohen për këto kategori të pajisjeve: lavatriçe, pjatararëse, frigorifer, ngrirës dhe televizor.

